

# AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

## UDHËZUES PËR SUBJEKTET E LIGJIT PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

22.12.2025

Në datën 11.12.2025, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin Nr. 84/2025 “Për marrëveshjen e pages fiskale”, i cili përcakton rregullat dhe procedurat për lidhjen e marrëveshjes vullnetare ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore, për pagimin e tatimit mbi të ardhurat e korporatave ose të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi, bazuar në vlerësimin e fitimit të tatueshëm, si dhe të drejtën për rivlerësimin e pasqyrave financiare të tri viteve të mëparshme.

Qëllimi i këtij udhëzuesi, është të sqarojë për subjektet e ligjit nr.9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (PP/FT), i ndryshuar, detyrimet e tyre në lidhje me zbatimin e legjislacionit PP/FT dhe qëndrimin e Agjencisë së Inteligjencës Financiare m (AIF), në lidhje me procedurën e marrëveshjes së deklarimit vullnetar.

AIF, informon të gjitha subjektet, se ligji Nr. 84/2025, nuk ofron asnjë lloj imuniteti administrativ ose penal ndaj veprimeve të tatimpaguesve për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo për çdo vepër tjetër penale, që lidhet me origjinën e jashtëligjshme të fondeve apo pasurisë dhe për rrjedhojë nuk cënon zbatimin e asnjë prej detyrimeve të ligjit nr.9917/2008.

Bazuar dhe në procese të ngjashme në nivel ndërkombëtar, ekziston një rrezik i shtuar që klientët të caktuar mund ta keqpërdorin procedurën e deklarimit vullnetar, për të ligjëruar fonde që burojnë nga vepra penale, duke paraqitur të dhënat apo dokumentacionin e marrëveshjes së lidhur me Autoritetin Tatimor. Ky rrezik duhet të merret në konsideratë nga ana e subjektit, në zbatimin e masave parandaluese dhe në varësi të klientelës që përfshihet në këtë proces, të rishikojë dhe dokumentin e vlerësimit të riskut PP/FT.

Në këtë kuadër, të gjitha marrëdhëniet e biznesit ekzistuese apo dhe ato të reja që subjektet vendosin me klientët e tyre, ju nënshtrohen të gjitha detyrimeve të Vigjilencës së Duhur ndaj klientit, Njihe Klientin Tënd, identifikimit dhe verifikimit të klientit dhe pronarit përfitues, monitorimit të marrëdhënies së biznesit dhe transaksioneve përkatëse, analizimit të informacionit, raportimit të aktivitetit të dyshimtë (RAD) dhe raportimit të transaksioneve në para fizike (RTPF) dhe mbajtjes së të dhënave.

Fakti që ligji ka si objekti të nxisë tatimpaguesit, të përmbushin në mënyrë vullnetare, detyrimet për tatimin mbi të ardhurat e korporatave ose tatimin mbi të ardhurat personale nga biznesi, si dhe rivlerësimit të pasqyrave financiare nëpërmjet një marrëveshjeje me Autoritetin Tatimor, nuk përbën asnjë pengesë për zbatimin e detyrimit që subjektet e ligjit, kanë për raportimin e aktivitetit të dyshimtë (RAD) në AIF. Për subjektet e ligjit, paraqitja e dokumentacionit në kuadrin e deklarimit vullnetar, nuk përbën provë të origjinës së ligjshme të fondeve apo transaksioneve që ato kryejnë me klientët (përfshirë këtu dhe shërbimet e natyrës profesionale që ofrohen për këtë qëllim).

Ky dokument përmban një sërë treguesish, që lidhen me deklarimin vullnetar, të cilët shërbejnë për përmbushjen e masave parandaluese të PP/FT, nga subjektet e ligjit. Lista e treguesve nuk është shtrënguese dhe duhet të shqyrtohet nga subjektet, së bashku me të gjithë informacionin e disponueshëm mbi klientin. Këta tregues, nuk përbëjnë domosdoshmërisht baza për dyshim dhe nuk përfshijnë të gjitha rastet, të cilët

kërkojnë një shqyrtim të thelluar të transaksioneve apo marrëdhënieve të biznesit, që mund të lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo financimin e armëve të dëmtimit në masë.

- Klienti nuk është në gjendje të ofrojë dokumente ose informacione të përshtatshme që shpjegojnë burimin e fondeve, që përdoren në kuadrin e deklarimit vullnetar;
- Mospërputhje midis informacionit të dhënë si pjesë e procesit të vigjilencës së duhur ndaj klientit dhe informacionit të dhënë si pjesë e procesit të deklarimit;
- Ka dyshime në lidhje me pronarin/ët e përfitues të subjektit që kryen deklarimin vullnetar;
- Transaksione të subjektit, që mund të lidhen me vende të konsideruara me rrezik të lartë ose vende që nuk zbatojnë në mënyrë efektive Rekomandimet e FATF;
- Transferta të fondeve jashtë vëndit, drejt vëndeve të ndryshme të pa justifikuar nga pikëpamja ekonomike apo ligjore;
- Klienti tregon interes të veçantë në lidhje me detyrimet e ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, veçanërisht për raportimin në AIF;
- Transaksione apo depozitime në llogari në vlera të larta dhe të pazakonta, me para në dorë;
- Veprimet e ndërmarra në lidhje me procesin e deklarimit vullnetar, që duket se synojnë të shmangin detyrimin për raportim;
- Lëvizje e shpejtë e fondeve, ose ndarje e shumave të mëdha në depozita më të vogla (strukturim) për të shmangur pragjet e raportimit, në kuadrin e zbatimit të deklarimit vullnetar;
- Transaksione që nuk mbështeten me të dhënat apo informacionin përkatës, ose dyshime në lidhje me ligjshmërinë e dokumentacionit të ofruar për burimin e fondeve;
- Klienti ngurron të japë informacion në lidhje me transaksionet ose shfaq një interes të pazakontë për mënyrën se si do të raportohen ato në kuadrin e zbatimit të legjislacionit në fushën e parandalimit të PP/FT.

Më këtë udhëzues duhet të njihen të gjithë punonjësit e subjekteve të ligjit dhe treguesit të përfshihen në trajnimet e subjektit.

Në tetor 2012, FATF publikoi një dokument që përcaktonte katër parimet në vijim, që vendet duhet të zbatojnë në mënyrë që të parandalojnë abuzimin e procesit të zbulimit vullnetar për qëllime pastrimi parash dhe financimi të terrorizmit:

**Parimi 1:** Zbatimi efektiv i masave parandaluese të PP/FT është një parakusht për adresimin dhe zbutjen e rreziqeve të PP/FT, që lidhen me zbatimin e çdo lloj programi vullnetar të përputhshmërisë tatimore.

**Parimi 2:** Rekomandimet e FATF, nuk lejojnë përjashtime të plota ose të pjesshme nga kërkesat e legjislacionit të parandalimit të PP/FT, në kontekstin e zbatimit të një programi vullnetar të përputhshmërisë tatimore. Gjatë zbatimit të këtij programi, autoritetet kombëtare duhet të sigurohen që kërkesat e tij nuk lejojnë, në ligj ose në praktikë, përjashtime të plota ose të pjesshme nga kërkesat e parandalimit të PP/FT, siç përcaktohet në Rekomandimet e FATF. Programet vullnetare të përputhshmërisë tatimore që e bëjnë këtë janë në shkelje të Rekomandimeve të FATF.

**Parimi 3:** Gjatë zbatimit të një programi vullnetar të përputhshmërisë tatimore, të gjitha autoritetet kompetente në vend, duhet të jenë në gjendje të koordinohen dhe bashkëpunojnë, si dhe të shkëmbejnë informacion, sipas rastit, me qëllim zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të çdo abuzimi të programit, me detyrimet ligjore për parandalimin e PP/FT.

**Parimi 4:** Nga autoritetet kompetente në vend, duhet të ofrohet gama më e gjerë e mundshme e ndihmës së ndërsjellë ligjore dhe shkëmbimit të informacionit në hetimet, ndjekjet penale dhe procedurat përkatëse të PP/FT që lidhen me abuzimin e programeve vullnetare të përputhshmërisë tatimore, duke përfshirë hetimet dhe procedurat e rikuperimit të aseteve.

Parimet e sipërmëndura të FATF, janë themelore në punën e AIF, në funksion të zbatimit të masave efektive për të parandaluar abuzimin e procesit të deklarimit vullnetar, ndalimin e përjashtimeve nga detyrimet në lidhje me PP/FT, koordinimin dhe bashkëpunimin me autoritetet kompetente në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.